



Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional

RUAJTËSI I PASURISË DHE ROLI I TIJ NË SIGURIMIN PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

● ● BULETINI ELEKTRONIK
● ● **E-MAPAS**
● ● BP.58

Në sigurimin pensional me financim kapital, si pjesë e sistemit pensional, mjetet që paguhen në llogaritë individuale të anëtarëve të fondeve pensionale investohen me qëllim të realizimit të kthimit dhe sigurimit të mjeteve për pagesën e pensioneve të ardhshme ose të dëmshpërblimeve pensionale. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre mjeteve dhe nevojën për mbrojtjen maksimale të tyre, ligjvënësi ka vendosur një ndarje të qartë të kompetencave ndërmjet institucioneve që marrin pjesë në sistem. Kështu, shoqëritë pensionale marrin vendime investuese dhe menaxhojnë mjetet e fondeve pensionale, ndërsa ruajtja e tyre dhe kontrolli i aktiviteteve të caktuara i janë besuar një personi juridik të pavarur – ruajtësit të pasurisë (Custodian).



Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ruajtësi i pasurisë mund të jetë ekskluzivisht banka e cila posedon lehtësi pune të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e cila plotëson kushtet e përcaktuara me ligj në lidhje me stabilitetin financiar, pavarësinë dhe organizimin e punës. Për më tepër, zgjedhja e ruajtësit të pasurisë është lëndë e pëlqimit paraprak nga MAPAS, gjë që siguron kontroll shtesë gjatë zgjedhjes së tij.

Ligji parashikon që mjetet e çdo fondi pensional të ruhen veçmas nga mjetet e bankës – ruajtësi i pasurisë, si dhe nga mjetet e klientëve të tjerë. Kjo ndarje siguron që mjetet e fondeve pensionale në çdo moment të jenë të evidentuara qartë dhe të mbrojtura juridikisht. Njëkohësisht, të gjitha instrumentet financiare në të cilat janë investuar mjetet e fondit pensional ruhen detyrimisht te ruajtësi i pasurisë. Janë parashikuar edhe garanci shtesë për mbrojtjen e mjeteve. Mjetet e fondeve pensionale që ruhen te ruajtësi i pasurisë nuk paraqesin pjesë të pasurisë së bankës, nuk mund të jenë lëndë e përmbarimit

kundër bankës dhe nuk hyjnë në masën e falimentimit ose të likuidimit nëse ndaj bankës hapet një procedurë e tillë. Me këtë sigurohet një shkallë e lartë e mbrojtjes juridike dhe financiare të mjeteve të anëtarëve të fondeve pensionale.

Ruajtësi i pasurisë paraqet një nga mekanizmat kryesorë për mbrojtjen e mjeteve të fondeve pensionale. Roli i tij nuk përbëhet vetëm në ruajtjen e sigurt të mjeteve, ruajtësi i pasurisë kryen edhe aktivitete të rëndësishme kontrolli. Ai verifikon nëse transaksionet dhe investimet ekzekutohen në përputhje me dispozitat ligjore, llogarit dhe konfirmon vlerën e mjeteve neto dhe të njësisë kontabël të fondit pensional, ndjek harmonizimin e portofolit me kufizimet e investimit dhe ka detyrim ligjor që pa vonesë të njoftojë MAPAS-in nëse konstaton parregullsi ose veprime në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional. Në këtë mënyrë vendoset një nivel shtesë i sigurisë dhe kontrollit, i cili kontribuon në mbrojtjen e mjeteve të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale.

Funksionet kryesore të ruajtësit të pasurisë janë:

- Segregacioni (ndarja) e mjeteve: Paratë e anëtarëve të fondit pensional ruhen në llogari të veçantë. Nëse shoqëria pensionale dështon ose përballlet me probleme financiare, mjetet në fondin pensional mbeten të paprekura dhe të sigurta sepse nuk janë pjesë e masës së falimentimit të shoqërisë.
- Evidenca e instrumenteve: Banka regjistron dhe ndjek të gjitha instrumentet financiare (aksione, obligacione, udhëheqje/pjesë) në të cilat shoqëria pensionale i investon mjetet e fondit pensional.
- Kontrolli i transaksioneve: Ekzekuton urdhëresat për blerjen ose shitjen e letrave me vlerë vetëm nëse ato janë në përputhje me rregulloret dhe me limitet e parashikuara të investimit.
- Ndjekja e flukseve të parave: Të gjitha hyrjet (kontributet) dhe daljet (pagesat e pensione-ve) zhvillohen ekskluzivisht përmes llogarive të hapura pranë bankës ruajtëse.

Kur mjetet e fondit pensional investohen jashtë vendit, ruajtësi i pasurisë zgjedh një nën-ruajtës të pasurisë (Sub-custodian). Ajo është një bankë e madhe ndërkombëtare ose institucion financiar i specializuar që fizikisht i ruan letrat me vlerë të blera në bursat e huaja.

Ruajtësi i pasurisë paraqet një element të rëndësishëm në sigurimin pensional me financim kapital dhe kontribuon ndjeshëm në sigurinë, transparencën dhe besimin në sistemin pensional.

”

„Solidariteti i vërtetë mes gjeneratave pasqyrohet në një sistem pensional të drejtë dhe të qëndrueshëm.“

”

„Investimi në sistemin pensional sot do të thotë ndërtimi i një themeli të fortë për të ardhmën tonë.“



Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS), Remzi Bajrami, së bashku me anëtarët e Këshillit të Ekspertëve, Pranvera Suma dhe Darko Sazdov, si dhe Këshilltaren Kryesore të Kryetarit të MAPAS-it, Marija Popovska, zhvilluan një takim pune me anëtarët e Bordit Mbikëqyrës dhe Bordit Drejtues të Shoqërisë Pensionale VFP SH.A. Shkup.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



EDUKIMI FINANCIAR PËR NXËNËSIT E KLASËS SË 8-TË

Agjencia për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital (MAPAS), së bashku me tre shoqëritë pensionale – BK Shoqëria e parë pensionale, Shoqëria pensionale SAVA dhe Shoqëri pensionale TRIGLLAV, në SHF “Goce Delçev” – Aerodrom, Shkup, mbajtën një ligjëratë edukative rreth njohurive financiare dhe njohjen e nxënësve të klasës së 8-të me pensionin dhe funksionimin e sistemit pensional.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



TAKIM KOORDINUES PËR INTEGRIMIN E EDUKIMIT FINANCIAR NË ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM NË RMV

U mbajt takim koordinues për avancimin e edukimit financiar në procesin arsimor (për publikim në ueb dhe media sociale)

Në organizim të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS, si anëtare e Trupit Koordinues për Edukim Financiar dhe Inkluzion Financiar, u mbajt takim koordinues kushtuar mundësive për integrim më sistematik dhe më të qëndrueshëm të edukimit financiar në arsimin fillor dhe të mesëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



PUNONJËSIT E MAPAS-IT DHE ANËTARËT E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE MORËN PJESË NË AKSIONIN E DHURIMIT TË GJAKUT

Punonjësit e Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS, së bashku me anëtarët e Këshillit të Ekspertëve, morën pjesë në një aksion vullnetar për dhurimin e gjakut, i cili u zhvillua në Qendrën për Dhurimin e Gjakut “Dare Xhambaz” në Shkup.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



Kryetari i Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional–MAPAS, Remzi Bajrami, dhe anëtarja e Këshillit të Ekspertëve, Pranvera Suma, morën pjesë në një takim pune me delegacionin e Agjencisë Kroate për Mbikëqyrjen e Shërbimeve Financiare (HANFA), i cili u mbajt në periudhën 9–12 qershor 2026, në organizim të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (ASO).

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.



KENI PYETJE OSE ANKESA?
Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në
contact@mapas.mk

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Тел: (02) 3224 229
www.mapas.mk

